



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 36 Dt 13 .09.2024

**MBI MIRATIMIN E KALIMIT TË DHURIMIT TË FAMILJES SË BLETËS DHE
MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE TË BLETARISË SIPAS PROJEKTIT
“NXITJA E TË RINJVE NË BUJQËSI DHE MBËSHTETJA E BLETARISË MODERNE
NË QARKUN E KORÇËS”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 77, Vendimin e Këshillit të Qarkut Nr.25 datë 21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024, mbi bazën e dispozitave të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Tukiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim për Zhvillim dhe Statusin e Zyrës së Kordinimit të Programit TIKa-s në Shqipëri,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalimin e dhurimit të Familjes së Bletës dhe materialeve të tjera ndihmëse të bletarisë, 23 “Bletarëve të Rinj” me vlerë 154,488 lekë për një “Bletar të Ri” ose në vlerë totale 3,553,224 lekë.
2. Të miratojë kalimin e dhurimit të Familjes së Bletës dhe materialeve të tjera ndihmëse të bletarisë, shkollës “Profesionale Shërbime” Korçë në vlerën totale 1,109,640 leke.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, zivillimit ekonomik,shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zivillimit të territorit, të gjitha zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Erjon Nexhipi

Miratuar me / 14 / Vota
Vota Pro / 14 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /13/09/2024

Koncept.Këshilltari Juridik: *M.Bylykbashi*

Miratoi: *Sek. K.Q.K.: B. Mugo*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

**MBI MIRATIMIN E KALIMIT TË DHURIMIT TË FAMILJES SË BLETËS DHE
MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE TË BLETARISË SIPAS PROJEKTIT
“NXITJA E TË RINJVE NË BUJQËSI DHE MBËSHTETJA E BLETARISË MODERNE
NË QARKUN E KORÇËS”**

Në kuadër të zbatimit të projektit: “Nxitja e të Rinjëve në Bujqësi dhe Mbështetja e Bletarisë Moderne në Qarkun e Korçës”, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 77, Vendimin e Këshillit të Qarkut Nr.25 datë 21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024, mbi bazën e dispozitave të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Tukiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim për Zhvillim dhe Statusin e Zyrës së Koordinimit të Programit TIKÀ-s në Shqipëri u zhvillua projekti me të njëjtën temë.

Referuar thirrjes për marrjen pjesë në projektin “Nxitja e të Rinjëve në Bujqësi dhe Mbështetja e Bletarisë Moderne në Qarkun e Korçës” u vërejt një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish të cilët shprehën interesin e tyre për tu bërë pjesë e projektit.

Në bazë dhe në funksion të arritjes së qëllimit të projektit të interesuarit u vlerësuan sipas kriterëve të mëposhtme:

- Mosha
- Arsimi
- Punësimi
- Vendbanimi
- Eksperienca në bletërritje

Për vazhdimin e mëtejshëm të këtij procesi, Komisioni i Vlerësimit të “Bletarëve të Rinj”, bëri përzgjedhjen e “Bletarëve të Rinj”, sipas kriterëve të përcaktuara më sipër.

Në bazë të të dhënave të përgjithshme hartoi listën e personave sipas vendbanimeve në qarkun e Korçës që plotësonin kushtet për të marrë pjesë në projektin: “Nxitja e të Rinjëve në Bujqësi dhe Mbështetja e Bletarisë Moderne në Qarkun e Korçës”.

“Bletarët e rinj” u lajmëruan dhe u njohën me qëllimin, kushtet, të drejtat dhe detyrimet që do të kishin nga pjesëmarrja në këtë projekt.

Komisioni i Vlerësimit kërkoi nga “Bletarët e rinj” dokumenta mbështetëse të cilat shërbenin për të vërtetuar deklaratimet e tyre. Pasi u snqyrtuan dokumentat dhe nga informacioni i marrë u vërejt se 2 pjesëmarrës kishin Park të Regjistruar Bletësh në Zyrën e Regjistrimit Identifikimit të Fermave dhe Kafshëve të gjalla në sistemin “RUDA”. Nga dëshira dhe pasioni që kishin 2 të rinjtë për të mesuar ju dhe mundësia e certifikimit.

U miratua lista me 30 pjesëmarrës të cilët në përfundim të kursit të leksioneve dhe praktikës së ndjekur nga ana e tyre do të certifikoheshin si dhe do të merrnin 5 Familje Bletësh shoqëruar me mjetet bazë të bletarisë.

Me vullnet të lirë dhe për arsye personale 5 prej “Bletarëve të Rinj” të cilët morën pjesë në trajnim, u tërhoqën duke mos vazhduar më tej me fazat e tjera të projektit.

Ndodhur në këto kushte u vlerësua që pjesa e mbetur e pajisjeve ndihmëse të bletarisë dhe familjeve të bletës të dhurohen te Shkolla Profesionale Shërbime Korçë.

Konkretisht për Shkollën Profesionale Shërbime Korçë të dhurohen 35 Familje Bletësh dhe pjesa tjetër e mbetur e pajisjeve ndihmëse të bletarisë.

23 “Bletaret e Rinj” të mëposhtëm përfituan artikujt sipas vlerës përkatëse bashkëngjitur.

Emër	Mbiemër	Emër	Mbiemër
1.Oresti	Azo	13.Anxhela	Shkëmbi
2.Geriol	Kupe	14.Rigels	Foto
3.Xhozi	Kreka	15.Ildi	Tiko
4.Brilant	Limllari	16.Jovan	Foto
5.Roland	Hasanllar	17.Mateo	Bixhakas
6.Besa	Miminllar	18.Filadelfja	Mahmut
7.Vivjan	Miminllari	19.Orjon	Terolli
8.Mariol	Shkullaku	20.Dhimitra	Koroveshi
9.Ervis	Kapa	21.Vangjel	Dardha
10.Kledi	Beçoku	22.Xhesi	Hoxha
11.Naumçe	Nasto	23.Artiola	Duro
12.Marjan	Sterjo		

Nr.	Emërtimi i Artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi/lek	Vlera
1.	Zgjoje Technoset me dy kate, grumbullues poleni dhe dysHEME anti-varroa	Set	5	14,040	70,200
2.	Maskë & Xhaketë	Copë	1	1,320	1,320
3.	Dorashka Lëkure	Palë	1	720	720
4.	Tymse e kromuar, me kafaz	Copë	1	1,440	1,440
5.	Tel Galvanizuar (rul)1kg	Copë	1	600	600
6.	Rul Telash	Copë	1	300	300
7.	Levë J en	Copë	1	300	300
8.	Furçë Plastike	Copë	1	300	300
9.	Pirun Zhvulosës i Hëllë	Copë	1	300	300
10.	Sheqer (1 kg)	Copë	15	100	1,500
11.	Ushqim Blete i pasuruar (1kg)	Copë	5	192	960
12.	Fletë dylli	Copë	100	48	4,800
13.	Familje bletësh në 5 korniza me mëmë 1 vjeçare	Familje	5	9200	46,000
	Vlera pa TVSH				128,740
	TVSH 20%				25,748
	Vlera Totale				154.488

Për 23 “Bletaret e Rinj” vlera totale llogaritet në $23 \times 154,488 = 3,553.224$ lekë.

Ndërsa shkolla “Profesionale Shërbime Korçë” ” përfitoi artikujt e mëposhtëm sipas vlerës përkatëse.

Nr.	Emërtimi i Artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi/lek	Vlera
1.	Maskë & Xhaketë	Copë	5	1,320	6,600
2.	Dorashka Lëkure	Palë	5	720	3,600
3.	Tymse e kromuar, me kafaz	Copë	7	1,440	10,080
4.	Tel i Galvanizuar (rul)1kg	Copë	7	600	4,200
5.	Rul Telash	Copë	7	300	2,100
6.	Levë J cn	Copë	7	300	2,100
7.	Furçë Plastike	Copë	7	300	2,100
8.	Pirun Zhvulosës i Hollë	Copë	7	300	2,100
9.	Sheqer (1 kg)	Copë	105	100	10,500
10.	Ushqim Blete i pasuruar (1kg)	Copë	35	192	6,720
11.	Fletë dylli	Copë	675	48	32,400
12.	Centrifuge 4 korniza manual dadant	Cope	1	28,800	28,800
13.	Zgjidhje Technoset me dy kate, grumbullues poleni dhe dysneme anti-varroa	Set	35	14,040	491,400
14.	Familje bletësh në 5 korniza me mëmë 1 vjeçare	Familje	35	9,200	322,000
	Vlera pa TVSH				924,700
	TVSH 20%				184,940
	Vlera Totale				1,109,640

Koncept.Këshilltari Juridik: *M Bylykbasçi*

Data 23.08.2024

